

Tokë për Mbrojtjen dhe Rezistencë ndaj Përmytjeve:

Si mund të instrumentalizohet toka private në menaxhimin e rrezikut të përmytjes në të ardhmen?

COST Action LAND4FLOOD (CA 16209)



PËRMBYTJA KA NEVOJË PËR TOKË!

Pothuajse çdo ngjarje e përmytjeve masive e dekadave të kaluara është pasuar nga thirrje për ndërhyrje më të mëdha në territor për menaxhimin e përmytjeve. Megjithatë kjo ka çuar në përpjekje të konsiderueshme në menaxhimin e rrezikut nga përmytja, përdorimi i tokës për zbatimin e masave për uljen e rrezikut është ende i kufizuar. Një menaxhim më efektiv dhe efikas i tokës për ruajtjen dhe rezistencën e përmytjeve është i nevojshëm!

Ndryshimet klimaterike kanë të ngjarë të rrisin frekuencën dhe madhësinë e ngjarjeve të përmytjes. Ndërkohë që dëmet nga përmytjet ndodhin si në tokën publike ashtu edhe në ato private, ofrimi i hapësirës për administrimin e rrezikut nga përmytja është më e vështirë në tokë private. Pritat mund të ofrojnë vetëm mbrojtje të kufizuar dhe përmytja mund të pritët gjithashtu edhe në zonat që nuk janë përmytur në të kaluarën. Përgatitja e qyteteve dhe peizazheve për ngjarje më të shpeshta dhe më të mëdha përmytjeje është thelbësore. Ruajtja e ujit në zonat e mbajtjes dhe përgatitja e qyteteve për t'u përmytur pa dëme të mëdha janë të dyja opsionet për tu rishikuar në një situatë rritje të rrezikut nga përmytja.

KU TË AKOMODOJMË UJIN?

Por ku mund të vendosim bollëkun e ujit të përmytjes? Cikli i ujit ofron tre mundësi:

- (A) në rrethina, përpara se uji të arrijë lumenjtë;
- (B) në rrjedhën e sipërme të qyteteve në rezervuarët ujëmbledhës (depozitimi i përmytjes);
- (C) ose në qytete rezistent (qytete të planifikuara më mirë për t'i bërë ballë dëmeve nga përmytjet).

Kushtet teknike dhe hidrologjike për këto mundësi janë relativisht të njohura, por këto masa kanë nevojë për më shumë hapësirë toke - e cila shpesh është pronë private. Marrja e përdorimit të tokës private për nevoja publike është e ndërlikuar, kërkon kohë dhe është e kushtueshme. Instrumentalizimi i tokës private në proceset e mbrojtjes dhe rritjes së rezistencës ndaj përmytjeve nënkupton jo vetëm bashkërendimin e aktorëve dhe institucioneve të ndryshme në menaxhimin e ujit, por edhe përfshirjen e pronarëve të tokave në planet e menaxhimit të rrezikut nga përmytja.

Një pyetje thelbësore për ruajtjen dhe rezistencën ndaj përmytjeve është se si toka private mund të përdoret për të mbledhur ujin për të krijuar mjedise urbane më rezistente. Kjo kërkon të kuptuarit e efekteve hidrologjike, instrumentet e politikave të territorit, të drejtat e pronës, përfshirjen e palëve të interesuara, ekonominë e tokës dhe qeverisjen, etj. E ardhmja e menaxhimit të rrezikut nga përmytja ka ende nevojë për inxhinierinë hidraulike, por gjithashtu shkon shumë përtej kësaj discipline, pasi zgjidhjet shpesh kërkojnë negociata dhe nxitje të pronarëve të tokave për të lejuar instrumentalizimin e tokës së tyre.

PRIORITETI I TOKËS NË MENAXHIMIN E PËRMBYTJEVE

Menaxhimi i tokës shpesh adresohet si çështje dytësore në politikat e parandalimit të përmytjes dhe uljes së rrezikut, por duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje. Toka është një faktor thelbësor në mënyrën sesi shoqëritë përballen me ndryshimet e rrezikut nga përmytja, kështu që politikat duhet të fillojnë me menaxhimin e tokës për të përmirësuar parandalimin e përmytjeve dhe rezistencën ndaj tyre. Një nevojë thelbësore për mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë ndaj përmytjeve është që të zëvendësohet perspektiva tradicionale dhe t'i jepet përparësi menaxhimit të tokës.

EKSPERTIZË KOLEKTIVE NË INICIATIVËN "LAND4FLOOD"

LAND4FLOOD është një rrjet ekspertësh ndërkombëtar që mbledh ekspertizë se si mund të instrumentalizohet toka për menaxhimin e rrezikut nga përmytja. LAND4FLOOD përfshin palë të interesuara, praktikues dhe akademikë nga më shumë se 30 vende të Evropës dhe më gjerë, të cilët bashkëpunojnë për të eksploruar se si ta bëjnë tokën më të disponueshme për menaxhimin e rrezikut nga përmytja, me qëllim përgatitjen më të mirë të shoqërisë për rritjen e rreziqeve nga përmytja dhe pasojat e tyre. Kjo është një përpjekje ndërdisiplinore dhe ndërkombëtare. LAND4FLOOD mbledh, shkëmben dhe kërkon të ndërthurë njohuritë akademike me përvojën praktike. Është një rrjet i hapur - ne u bëjmë thirrje palëve të interesuara dhe akademikëve të bashkohen me ne në këtë nismë.

Bëhuni pjesë! Vizitoni land4flood.eu! Kontaktoni perfaqësuesin tuaj në LAND4FLOOD: Artan Hysa, ahysa@epoka.edu.al